UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

PUNIMI I DIPLOMES – MASTER

ANALIZA E ELEMENTEVE TEKNIKE TË FINALËS SË KUPES SË KOSOVËS 2019 PËR FEMRA NË VOLEJBOLL

Mentori:
Prof. Asoc. Dr. Musa Selimi

Kandidatja:
Emine Ramadani

Prishtinë, 2019

KV ”Skenderaj” nga Skenderaji.

KV “M-Technologie Prishtina Voley“ nga Prishtina

PËRMBAJTJA

1. HYRJE 3
1.2 HULUMTIMET E GJERTANISHME 7
2. QËLLIMI I PUNIMIT 11
3. HIPOTEZAT THEMELORE 12
4. METODAT E PUNËS 13
4.1. MOSTRA E ENTITETIT 14
4.2. MOSTRA E NDRYSHOREVE 14
4.3 TEKNIKA E REALIZIMIT TË NDRYSHOREVE MOTORIKE SITUACIONALE .. 15
4.4. METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE 22
5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUSUTIMI 23
5.1. ANALIZA E REZULTATEVE TEKNIKE TE LOJTARET E EKIPIT FITUES KV "SKENDERAJ" 23
5.2 ANALIZA E REZULTATEVE TEKNIKE TE LOJTARET E EKIPIT HUMBËS KV "M-TECHNOLOGIE PRISHTINA VOLEY" 31
5.3 KRAHASIMI I PIKËVE TË FITUARA SIPAS SETEVE NË MES KV "SKENDARAJI DHE KV "M-TECHNOLOGIE PRISHTINA VOLEY" 39
5.4 VËRTETIMI I HIPOTEZAVE 47
6. PËRFUNDIMI 48
7. LITERATURA 50

1. HYRJE

Volejbolli si sport ekipor, paraqet fushë ose lëmi shumë të rëndësishme, në të cilën volejbollisti në mënyrë specifike, mund t`i shpreh si dhe t`i tregoj krijimtarite e veta të veçanta lëvizore. Mendohet se njëri ndër motivet kryesore, i cili i lëvizë dhe i kyq njerëzit, që të merren me sport, është synimi ose pretendimi për mësuarjen, përsëritjen dhe përsosjen e aftësive lëvizore, pastaj organizimin më të mirë të procesit stërvitor, që ai të kuptohet si qëllim i ruajtjes dhe avancimit të shëndetit.

Në volejbollin modern, me analizën e frekuencës së veprimit në ndeshje, njëkohësisht fitohet një video analizë, e cila, për shembull, përcjell një lojtar dhe lëvizjen e tij në vetëm një rotacion. Efikasiteti i lojërave në atë rrotullim, dhe gabimet e regjistruara në të njëjtën analizë rotacioni, çojnë në përcaktimin e shkakut të gabimit (Đurković, 2007) dmth. Diagnostikimi i shkakut të humbjes së pikëve (Eom, me bp.,1992; Yiannis me bp., 2005). Për këtë arsye, trajneri duhet të dij modelet e performancës statistikore për ekipin, individin, fazat e lojës, pozicionet e lojtareve, disa sete, ndeshjet, etj. për shkak se duhet të diagnostifikoj arsyen e lojës së dobët në të gjashtë rrotullimet në të dyja komplekset e lojës. Respektivisht, në kompleksin K1, ku analizohen të gjitha veprimet e kryera nga një ekip, kur ka në pranim shërbimin dhe në kompleksin K2, të gjitha veprimet e kryera nga një ekip gjatë kryerjes së shërbimit (Zetoume bp., 2006).

Volejbollibën pjesënë grupin e lojërave sportive të intensitetit të lartëe të përhershëm,që e karakterizojnë periudhatë shumtae të shkurtëra, me intensitet të lartë eksploziv lëvizor, të ndarame periudhapushimi të shkurtër, gjatë së cilësvolejbollistimë shumë,ose më pakçlodhet. Si nëlojrate tjera sportiveapo skuadratsportive, në volejboll suksesivaret nga shumë faktorëtë ndërlikuardhe të ndërlidhur.

Me ndryshimet erregullavezyrtare tëvolejbollit,nëKongresin e 28 tëFIVB-es,janë ndryshuarrolet evolejbollistëve gjatë lojës. Rolet ereja nësulmdhe mbrojtje, kanë kushtëzuar nevojën përstudim mëintensivtë aftësive të volejbollistëve, sidomos aftësiae forcësshpërthyesetëmuskujve tëkëmbëve,që nëterminologjinë e volejbollit, i referohet kërcimitvertikal. Volejbolli si sport ekipor, paraqet fushë ose lëmi shumë të rëndësishme, në të cilën volejbollisti,në mënyrë specifike, mund t`i shpreh si dhe t`i tregoj në mënyrë të veçant krijimtaritë e veta specifike lëvizore. Mendohet se njëri ndër motivet kryesore, që i lëvizë dhe i

nxit njerëzit që të merren me sport, është synimi ose pretendimi për mësuarjen, përsëritjen dhe përsosjen e aftësive lëvizore, pastaj organizimi më i mirë i procesit stërvitor, që ai të kuptohet si qëllim i ruajtjes dhe avancimit të shëndetit.

Duke pasur parasyshë si dhe duke u bazuar në atë, se sporti në përgjithësi, si dhe loja e volejbollit në kuadër të kësaj,paraqet aktivitet kompleks të njeriut, definicioni i saj, mund të formulohet më së përafërmi, nëse vërtetohet dhe bazohet në disa karakteristika esenciale të këtij fenomeni: a) Volejbolli si sport është disiplinë sportive komplekse,dhendër sportet më të përhapura dhe më të rëndësishme të disiplinave sportive. b) Për shkak tëkarakteristikavetë veçantatë rritjesdhe të zhvillimit tëvolejbollistëve tërinj,stërvitjes së forcës eksplozive të këmbëve,duhett`i qasemime kujdes. Loja e volejbollitmund të luhet nëpesëpjesë, që do të thotë,se lojamund të zgjasërreth 90minuta,gjatë së cilës kohëvolejbollistët, ose volejbollistet kryejnë 250-300 aksione, në të cilat dominon forca eksplozive e muskujve të këmbëve. Nganumri i përgjithshëm, kërcimet përbëjnë50-60%tëaksioneve, lëvizjete shpejtadhe ndryshimi idrejtimitnë hapësirë, me rreth30%të aksioneve,dhe ramjetrreth15% të aksioneve.

Lartësia mesatare etrupittëvolejbollistëve bashkëkohorë, është më e lartë senë periudhën ehershme,dhendryshonndërmjet 195dhe 200cm. Lartësia mesatare e gjuajtësit, shërbyesit,është mesatarisht 345-355cm, ndërsa te lojtarët e bllokut320-335cm.(Grgantov, 2003). Në aksionete gjuajtjesdhe bllokut,dominon forca eksplozive,e cila referohetsi kërcim vertikalnëvolejboll,dhe nga kjoshpesh varetfitimi ipikëve.

Në bazë të modelit të karakteristikave, volejbollistët kulmor, përveçkarakteristikaveantropometrike, kanë aftësi të kërcimit nga vendi dhe nga lëvizja,si dhe zhvendosje të shpejtë në hapësirënënjë distancë të vogël. Duka pasur parasyshë se lartësia e trupit e volejbollistëve të stërvitur, nuk mund të ndryshohet, lartësiabrenda mundësivenëkërcim së larti gjatë gjuajtjes dhe bllokut (kërcimi vertikal),mund të rritet me stërvitje.

Kërkesate vendosurapërparavolejbollistëvengaviti në vit, janë duke u rriturnë mënyrë kontinuele. Çdo herë është në rritje numri ilojërave nënjë sezon, në klube dhe përfaqësuese, me një nivel më të lartëcilësor garues. Si pasojë, shfaqet nevojapër rritjene aftësive kondicionale, gjë që do të siguroj, që volejbollisti të luajë njësezontë tërëpalëndimedhenënivel më të lartëtë mundësive. Përgatitjet kondicionale luajnë një roljashtëzakonishttë rëndësishëm nëbotën modernetë sportit kulmor.Volejbolli bashkëkohor,kërkon nga të gjithëvolejbollistët njënivel të lartë tëaftësivetë përgjithshme dhe specifikemotorike,karakteristike për lojën

evolejbollitdhepërpozitatë caktuara(vende) të lojtarëve.Lojtaretduhettë jenë të përgatiturapër të kryer çdo element tekniko-taktikme një efikasitet sa më të lartë të jetë e mundur.

Që kjo tëarrihet para se gjithash, është e nevojshme përgatitja adekuateoptimalefizike tevolejbollistet. Çdoelementtekniki lojës së volejbollit,nukështë e mundur të ekzekutohet papërgatitje fizike adekuate(p.sh., të goditurit etopit,nukdo të jetë efektiv,nësevolejbollistinukshfaqnivelinoptimal tëfuqisë dhe shpejtësisë, kërcimi në gjuajtje jashtëzakonishtmanifestohet me forcë eksplozivetëkëmbëve, etj.). Ngakjovaret cilësiae lojës,dhenë fund të fundit,fitorja në ndeshje, çka është imperativ e çdo loje (Jovanovic, 2006).

Volejbolli numërohet në grupinelojëravesportive, tek e cila është e nevojshme,përveçkërcimit, ose forcës eksplozivevertikalepër çdolojtar, të dinlartësinëe tyretë arritshme të tillasi: lartësiabrenda mundësivenë kërcimin nga vendi me dy duar (manifestohet me rastin e bllokimit), lartësia brenda mundësive nga vendi me një dorë (vjen në shprehje me rastin e shtyrjes së topit me një dorë në bllok, transferimine tij mbi bllok,dhe shumëforma të tjera tëveprimitmetopmbi rrjetë), lartësiabrendamundësiveme një dorënga vrulli (lartësia brenda mundësivegjatë gjuajtjes).

Forca eksplozive e këmbëve, është shumë e rëndësishme gjatë kërcimit vertikal dhe shpejtësisë së lëvizjës në fushë**.** Duke u nisur nga ajo, se forca eksplozive, mund të arrihet vetëm me punë të intensitetit të lartë, e cila nuk zgjat shumë, është e qartë se burimet e saj të energjisë, janë mekanizmat anaerob kryesisht fosfagjen ose alaktat. Puna në rritjene forcëseksplozive,gjithmonë bazohet në ngritjen e mekanizmave fosfagjen dhe rritjen e përqëndrimit të ATP, dhe CP në muskujtaktiv. Aftësitë motorike nuk janë gjithmonë nga faktorët vendimtar për rezultatin përfundimtar (rezultati i garës), por janë të rëndësishëm, dhe për këte u kushtohet rëndësi e veçantë. Kërcimi vërtikal, në situata të ndryshme, është forma dominuese e lëvizjes në lojën e volejbollit.

Analiza integrale e lojës, përfshinë një sërë veprimesh tëorientuara në vëzhgimin, monitorimin, grumbullimin, ruajtjen, përpunimin, interpretimin dhe prezantimin e të dhënave për lojën e skudrës së vet,dhe lojën e skuadrës kundërshtare, gjatë dhe pas lojës. Duke pasur parasyshë specifikat e skuadrës së volejbollit, duhet të praktikohen të gjitha gjashtë rotacionet e lojës. Renditja e saktë e caktuar e lojtareve në rrjet dhe në fushë në një rrotullim të caktuar, mund të rezultojë me një lojë më shumë, ose më pakë të suksesshme, në të cilën ndikojnëfaktorë të

shumtë, siç janë: njohuritë teknike dhe taktike të lojtareve, karakteristikat antropometrike, aftësitë e tyre motorike, funksionale dhe njohëse dhe karakteristikat konative.

Formimi i lojtarëve kulmor në volejboll,është procesi ndërlikuar,me të cilinproces kuptojmë të mësuaritkuantitativ dhe kualitativ, si dhe përsosja e tyre në një shkallë më të lartë. Në formimin e gjatë të një volejbolliste, specializimi i rolit të saj,paraqet një proceskomplekstëtë mësuarit të elementeve teknike dhe taktike, menjë fokus të veçantnëpërgatitjen fizike të saj, si dhe fazën e zgjedhjes dhe formimit tëlojtaresnëatë rolnë lojë,kuajomaksimalishtmund tëshfrytëzojëedheparadispozitate veta.

Në këtë mënyrë, specializiminëvolejbollpërfshin formimin edhe të ngritëses,apo tëorganizatores sëlojës, pranueses-sulmueses, lojtaresqendrore, korrektores(lojtares diagonale) dhe Liberos së përgatitur përpritjen e shërbimitdhe mbrojtjen e fushës. Prioritetnë procesin especializimit,do të ketë puna ediferencuarmeçdo rol të lojtares veç e veç, dhepunaintegruese e tyre gjatë lojës.

Volejbolliështë një lojëkolektive,që i vëlojtarëtpara njënumri tëkërkesaveqë, ndër të tjera, i përkasinfushës sëaftësiveintelektuale. Këto kërkesakanë të bëjnënë të mbajturit mend të faktevetë thjeshta etë lidhura merregullat e lojës, por edhe perceptimine shpejtëdhetë saktë tëgjendjes në fushë, si dhe përzgjedhjessëlëvizjevemëracionalenë lojë,që tëfitohet iniciativa në grup.

Gjithashtugjatëzgjedhjes sëtaktikave, bëhet edhe vlerësimi imundësive tëbashkëlojtarëvedhe kundërshtarëve, dhenë raport me këto, bëhen parashikimet esjelljes dhe potezave të tyre, për çfarë,janë të nevojshmeprocesetmëkompleksemendore. Është eqartë,seroliiaftësiveintelektuale, ose kognitive nërealizimin e detyrave në lojën e volejbollit,nukmund të injorohet, porparashtrohet problemi i peshës dhe strukturës sëkëtyre detyravenë fushën kognitive, respektivisht grup të shkathtësive intelektualetë nevojshmepërrealizimin elojës sëvolejbollit.

1.2 HULUMTIMET E GJERTANISHME

Cili do problem teknik apo taktik, është e mundur të operacionalizohet në shumë mënyra të ndryshme. Megjithatë natyra e shumicës së problemeve dhe karakteristikave teknike dhe taktike, shpesh kërkojnë një qasje multivariante.Në këtë drejtim, janë bazuar edhe hulumtimet e gjertanishme, por shumë të pakta janë ato, të cilat kanë pasur qëllim të hulumtojnë rëndësinë dhe ndikimin e vetëm një elementi teknik në suksesin e arritur në lojëne volejbollit.

Inkinen me bo. (2013) duke përdorur analizën notanale, analizuan efikasitetin e elementeve tekniko-taktike në garat e volejbollit të femrave për junior dhe senior. Qëllimi i tyre ishte të krahasojnë performancën në këto dy nivele të moshës së garave, dhe të sqarojnë dallimet midis ekipeve fituese dhe të mundura në setet e volejbollit. Rezultatet treguan se ekzistojnë vetëm dallime të vogla në mes junioreve dhe senioreve. Efekasiteti i gjuajtjeve është treguar të jetë parashikuesi më i rëndësishëm i suksesit edhe te junioret edhe te senioret.

Peña me bp. (2013) një mostër prej 125 ndeshjesh të luajtura gjatë sezonit 2010/2011, në kampionatin e volejbollit të ligës së parë spanjolle, hulumtuan se cilat aftësi dhe faktorë, ndikojnë në rezultatin e ndeshjes së sezonit të rregullt të volejbollit, dhe rëndësinë e tyre për arritjen e rezultateve pozitive në lojë. Ndeshjet janë luajtur nga ana e 12 ekipeve, të përbërë prej 148 lojtarëve, nga 17 vende të ndryshme, nga tetori 2010 deri në mars 2011. Variablat e analizuara ishin rezultatet e ndeshjes, 43 kategoritë e ekipeve, faktorët, terreni vendas dhe mysafir, pika e fituar nga kundërsulmi, numri i gabimeve në shërbim, numri i as-shërbimeve, numri i gabimeve në pranim, përqindja e pritjeve pozitive të përsosura, efikasiteti i pritjes, numri i gabimeve në sulm, numri i sulmeve të bllokuara, pikët e fituara nga sulmi, përqindja e pikëve në sulm, efektiviteti i sulmit dhe numri i bllokimeve të të dy ekipeve në ndeshje. Rezultatet treguan se variablat e kategorive të ekipeve, pikët e fituara në kundërsulm, numri i gabimeve në pranim, dhe numri i pikëve të shënuara nga blloku, ishin faktorë të rëndësishëm për fitoren ose humbjen. Raporti i shanseve, tregon shanset për të fituar në lojën e volejbollit 6,7 herë më të madha për ekipet më të ranguara, dhe se çdo pikë shtesë në kompleksin 2, rrit mundësinë për të fituar 1.5 herë. Çdo gabim në pranim dhe bllokimin e topit,zvogëlojnë mundësinë për të fituar 0.6 ose 0.7 herë.

Silva me bp. (2013) kanë studiuar se çfarë ndodh, kur ngritësi në fushën e sulmit (zona 4, 3 dhe 2) dhe në identifikimin e aftësive që ndikojnë, të cilat ndikojnë më tepër fitoren, apo humbjen në lojë. Njëzet e katër ndeshje (n = 24) të luajtura gjatë Kampionatit Botëror për senior për meshkuj në Itali, në vitin 2010, janë analizuar me ndihmën e paketës programore Data Volley. Është vërtetuar se pikëshërbimi, gabimi në shërbim, ngritja ideale, gabimi në ngritje, gabimi në sulm, dhe mbrojtja ideale e fushës, janë variabla thelbësore, të cilat përcaktojnë rezultatin përfundimtar të lojës (fitore / humbje), kur ngritësi është në fushën e sulmit(zona 4, 3 dhe 2). Ekipet me më pak kualitet sulmi, shërbimi dhe organizimi të dobët të lojës, do të jetë e vështirë për të fituar, sepse këto aftësi janë të rëndësishme për ndërtimin e sulmit dhe fitores. Silva et al. (2013) hulumtuan variablat vendimtare sipas pozitës së ngritësit në zonën mbrojtëse (Zona 1, 06:05) në 49 ndeshje të luajtura në finalen e garave të rëndësishme ndërkombëtare të luajtura në mes të 2010 dhe 2012 (në Kupën e Botës, liga Evropiane, Kampionati Europian, Liga botërore, Lojërat Olimpike). Të dhënat u grumbulluan duke përdorur paketën e programeve Data Volley. Rezultatet treguan se gabimet në pranim, pika nga kundër- sulmi, gabimi në ngritje, dhe pika nga sulmi, janë variabla të rëndësishme, që mund të identifikojnë rezultatin përfundimtar (dmth, fitore apo humbje) në ndeshjen, kur ngritësi ishte në rreshtin e dytë.Në fakt, ky hulumtim shpjegon pse ekipet e volejbollit po fitojnë; poentimi nga sulmi, dhe kundërsulmi, shpesh parashikon një rezultat fitues. Ky hulumtim,përbën një kontribut të rëndësishëm në trajnimin e volejbollisteve dhe garave.

Campos me bp. (2014) kanë hulumtuar përparësinë e lojës si vendase te ligat e volejbollit elitë për femra, dhe ndikimin e treguesve të performancës në rezultatin e ndeshjes sipas numrit të seteve. Mostra përbëhej nga 240 ndeshje (132 ndeshje të Ligës së Volejbollit Brazilian) dhe 108 ndeshje të Ligës Italiane të Volejbollit në sezonin 2011-2012. Është vlerësuar raporti i treguesve të suksesit (duke përfshirë shërbimin, sulmin, bllokimin dhe gabimet e kundërshtarit) dhe rezultatin e ndeshjes (fitore ose humbje). Rezultatet treguan ekzistimin e efektit të përparsisë së terenit vendor te ligat e volejbolit për femra, me frekuencion më të shpeshtë të fitoreve si vendas për ligën braziliane dhe italiane (58 dhe 56%). Rezultatet treguan,që ekzistimie efektit të avantazhit,më tepër ishte kryesisht i lidhur me fitoren, dhe ishte një tregues teknik, që shpjegoi pjesën më të madhe të rezultateve në ndeshje.

Costa me bp. (2014) analizuan korrelacionin e cilësisë së pranimit të shërbimit, kohën e sulmit dhe llojin e bllokut, lloji i bllokut me efikasitet dhe llojin e sulmit. Mostra e subjekteve të

anketuar përfaqësonte 18 ndeshje të Superligës braziliane për volejbolliste në sezonin e garave 2011/2012. Në total u analizuan 2348 aksione në sulm. Rezultatet treguan, se gabimet në sulm janë të lidhura me bllokun e dyfishtë, ndërsa sulmet pas së cilës topi mbeti në lojë, ishin të lidhura me blloqet e dyfishta dhe trefishe. Kjo tregon mbi respektin, që lojtarët kanë kur gjuajnë përballëbllokut të trefishtë, sepse zgjedhin sulme më pak të rrezikshme me qëllim, që topi të mbetet në lojë. Pranimet ideale të shërbimeve, që i lejojnë teknikeve të ndërmarrin aksione të ndryshme në sulm dhe sulme të forta, janë të lidhura me përfundimin e aksioneve pas gjuajtjes. Ritmi i sulmit, ishte negativisht i lidhur me precizitetin e ngritjes, nga e cila theksohet, se skuadrat e ekipet braziliane të femrave ende kanë hapësirë për përsosjen e lojës së shpejtë të sulmit, ose që nganjëherë në situata ku kjo nuk është e justifikuar taktikisht forcojnë ndeshjet me ritme të shpejta.

Lin (2014) analizoi mundësinë e aplikimit të teorisë së lojërave sportive në krijimin e një strategjie për një konkurrent të veçant në ndeshje. Kjo strategji që krijohet para garës, gjatë lojës, përshtatet me rrethanat e reja sipas nevojës. Autorja arrin në përfundimin, se volejbollistet dhe volejbollistët, mund të ndjekin udhëzimet strategjike dhe të bëjnë rregullimet e nevojshme gjatë lojës. Rezultatet e fituara, tregojnë se teoria e lojërave sportive, mund t'u ofrojë trajnerëve dhe lojtarëve, informacione të dobishme për krijimin dhe zbatimin e strategjisë gjatë lojës.

Marcelino me bp. (2014) analizuan gjasat e parashikimit të rezultatit të një sulmi në volejbollin elitar tek mashkujt. Në 19 ndeshje të Kampionatit Botëror të Volejbollit për meshkuj të vitit 2006, morën parasysh dimensionet lidhur me hapësirën, detyrat, lojtarët dhe efektivitetin e aksioneve të përzgjedhura (pranimi, ngritja dhe sulmi). Është aplikuar logjika multinomiale e regresionit me shkallë të rëndësisë .05. Rezultatet treguan se sinjalet më të rëndësishme për parashikimin e një sulmuesi të caktuar, lidhen me aspektet e ngritjes së topit (zona e ngritjes, pozita e ngritësit, lloji i ngritjes), pozicionin e lojtarit në mes, dhe lojtarët pranues. Në tërësi, zgjedhja e sulmuesve është shumë e parashikueshme, dhe mund të pritet nëpërmjet analizës së shenjave vizuale që i paraprijnë sulmit. Njohja e këtyre modeleve do të rrisë shkallën e suksesit për ekipet mbrojtëse, ndërsa ekipet sulmuese duhet të përpiqen të krijojnë strategji, që do të përdorin mënyra të ndryshme të lojës në secilin grup, duke zvogëluar aftësinë e kundërshtarit për të parashikuar veprimet e tyre.

Laporta me bp. (2015) në një mostër prej 14 ndeshjeve të Kupës së Botës për femra, që luajtën në vitin 2013, u analizuan lëvizjet e volejbollit në mbrojtjet nga sulmi. Ata veçuan 277

aksione në këtë kompleks (K4), që është 4.1% nga numri i përgjithshëm i aksioneve. Nga këto 277 aksione, 128 u zhvilluan pas sulmit, pra, pas kompleksit 1 (K1) dhe 149 pas kundërsulmit, pra, pas kompleksit 2 (K2). Autorët kanë vërejtur gati 29 sisteme të ndryshme të mbrojtjes. Ato mund të ndahen në bazë të kriterit të numrit të rreshtave (linjave), që kanë formuar lojtarët në distanca të ndryshme nga rrjeta në sistemet e mbrojtjes në një, dy, tre dhe katër rreshta. Më shumë se 60% e aksioneve të mbrojtes kanë kryer në 2 rreshta, dhe një tjetër 1/3 në rreshtin e 3-të. Sistemet e mbrojtjes në një dhe katër rreshta së bashku, ndodhin në rreth 6% të aksioneve. Vetëm dy formacione (2: 2 dhe 2: 3) janë regjistruar në më shumë se 10% të aksioneve. Një numër i barabartë i aksioneve pas mbrojtjes së suksesshme (23%) përfunduan pas gabimit , apo pikëve të shënuara në një kundërsulm, dhe në aksionet e mbetura të lojës, vazhdon pas realizimit të kundër-sulmit. Autorët theksojnë nivelin e lartë të lidhjes midis tempos së sulmit, dhe strukturës së mbrojtjes së sulmeve në K1 dhe K2. Me këtë, sulmet me ritmin e parë jo vetëm që vështirësojn formimin e një blloku kompakt nga ana e bllokueseve rivale, por edhe bashkëlojtareve vështirësojn formimin e mbrojtjes efektive të sulmit. Në mënyrë indirekte, kjo lidhje ndikon gjithashtu në cilësinë e saktësisë (precizitetit) të pranimit dhe zonës së sulmit me strukturën e mbrojtjes së sulmit. Autorët arrijnë në përfundimin se gjatë përsosjes së këtij kompleksi të lojës, duhet të mësojnë parimet e mbrojtjes, e jo t`i përrmbahemi në mënyrë strikte formacioneve të caktuara (p.sh. 3: 2 ose 2: 3). Për shembull, një parim (këshilla apo udhëzime lojtarëve) me një mundësi shumë të gjerë aplikimi, do të jetë: "Nëse jeni afër mbroje fushën në afërsi të tij, por nëse ju jeni larg nga gjuajtësi, mbrojeni pjesën e thellë të fushës (pas linjës së sulmit)." Ky lloj i të mësuarit, mundëson fleksibilitetin e nevojshëm të lojtarit, pra, përshtatshmërinë e tyre ndaj situatave të ndryshme në lojë.

Palao me bp. (2015) krahasuan dallimet në frekuencën dhe cilësinë e performancës së disa elementeve teknike-taktike midis ekipeve fituese dhe humbëse në volejboll. U analizuan aksionet e 91 lojtarëve në 13,939 pikë gjatë 84 ndeshjeve (179 grupe) të luajtura gjatë Turneut Botëror të Volejbollit 2008. Realizimi i disa aksioneve u analizuan në lidhje me rezultatin e tyre, si dhe zgjedhjen e opsioneve, që ekipi kundërshtar kishte në dispozicion pas zbatimit të tyre. Analiza diskriminuese, zbuloi se ekipet fituese kanë performancë dukshëm më të mirë në kryerjen e shërbimit, panimit të shërbimit, ngritjes për gjuajtje dhe gjuajtjeve në sulm.

2. QËLLIMI I PUNIMIT

Specifikat e sporteve në rrjetë, janë se nëlojën e volejbollit, lojtari apo skuadra realizon pikë,duke goditur topin në hapësirën e fushës së skuadrës kundershtare me forcë dhe precizitet të mjaftueshëm, në mënyrë që lojtaret kundërshtaretë mos jenë në gjendjetë kthejnëtopinpara se tëbienjë herënë fushë. Për të arritur këtë, lojtaret, duhet të kenë ato veçori antropometrike dhe aftësi motorike në volejboll, që janë përgjegjëse për suksesin e tyre.

Prandaj edhe nga kjo kërkesë në aspektin antropologjik, lind edhe qëllimi i këtij punimi e që është të vërtetohet raporti i pikëve të fituara nga gjuajtjet mbi rrjetë, krahasuar me pikët e futara, nga elementet tjera teknike në lojën e volejbollit në mes të dy ekipeve finaliste të Kupës së Kosovës 2019 për femra.

Qëllimi dytësor i këtij punimi, është vërtetimi i kontributit të çdo lojtare në fushë në realizimin e pikëve tek dy ekipet finaliste të Kupës së Kosovës 2019 për femra.

3. HIPOTEZAT THEMELORE

Në përputhje me qëllimin dhe metodat statistikore për përpunimin e rezultateve formulohen dhe parashtrohen këto hipoteza:

H_1– Ekipi fitues, do të ketë numër më të madh të pikëve, të fituara nga gjuajtjet mbi rrjetë, krahasuar në pikët e fituara nga elementet tjera teknike gjatë lojës.

H_2 – Ekipi fitues, do të ketë numër më të madh të pikëve të fituara nga gjuajtjet mbi rrjetë, krahasuar nga ekipi humbës.

H_3– Ekipi fitues, do të ketë numër më të vogël të gabimeve, nga gjuajtjet mbi rrjetë, krahasuar nga ekipi humbës.

H_4 – Ekipi fitues, do të ketë numër më të vogël të pikëve të humbura nga blloku aktiv i ekipit kundërshtar.

H_5 – Ekipi fitues, do të ketë numër më të vogël të pikëve të humbura nga pasimet e gabuara.

H_6 – Ekipi fitues, do të ketë numër më të madh të pikëve të fituara nga ekzekutimi i shërbimeve.

4. METODOAT E PUNËS

Duke marrëparasysh natyrën e hulumtimit, është e nevojshme të kuptojmë,dhe tëpërdorim disametodamatematikoredhe statistikorenë këtë studim, ku dotë përzgjidhenato për të cilat supozohet, se do të ndihmojnënë nxjerrjen ekonkluzioneve rreth natyrës së problemit të parashtruar.

Sipasnatyrës sëkërkimit shkencor, ky studimi përketkategorisësë kërkimeveempirike, ndërsa sipas qëllimit tëndërmarrur, paraqet hulumtim aplikativ, i cilika për qëllimtë fituarit enjohurive dhe informacioneve të reja,të nevojshme përaplikim praktiknë fushën esportit, dhemarrë nëtërësi, në praktikatpedagogjikenëpër shkolla.

Në lidhje menjohjene problemit, ky studim paraqethulumtimkonfirmativ,ku në bazë të një problemi të njohur, kryhet kontrolli i hipotezave të parashtruara,duke përdorurmetoda të përshtatshmedhe draftekërkimore.

Në kushtet e përcaktimitkohor, studimi është i karakterit transversal, dhe konsiston nënjë matje vetëmtë treguesve të elementeve teknike gjatë lojës.

4.1. MOSTRA E ENTITETIT

Popullata nga e cila do të meret mostra për këtë punim, është definuar si popullatë e volejbollisteve seniore, lojtare të të dy klubeve, finalisteve të Kupës së Kosovës 2019 në volejboll, të KV "M-Technologie Prishtina Voley" dhe KV"Skenderaj" nga Skenderaji.
Në këtë hulumtim do të përfshihen gjithsej 30volejbolliste seniore,të tëdy klubeve të Superligës së Kosovës, edhe ate15 volejbolliste ose lojtare të KV"Skenderaj" nga Skenderaji,(volejbollistet që kanë shënuar fitore), dhe 15 volejbolliste ose lojtare KV "M-Technologie Prishtina Voley" nga Prishtina (volejbollistet që kanë shënuar humbje)

4.2. MOSTRA E NDRYSHOREVE

Në këtë punim si ndryshore do të aplikohen elementet teknike, të aplikuara gjatë lojësnë Kupën e Kosovës 2019 në volejboll, të M-Technologie Prishtina Voley dhe Skenderaj. Ndryshoret do të nxjerren si rezultate statistikore nga pikët e fituara, në mënyrë individuale dhe ekipore, si dhe nga analiza e elementeve teknike të ekzekutuara pa shënime të pikëve dhe me shënimin e pikëve.

4.2.1. Ndryshoret motorike situacionale (elementet teknike)

Do të aplikohen këto ndryshore si elemente teknike:

1. Pikët e fituara nga gjuajtjet mbi rrjetë (GJMRRF),
2. Pikët e humbura nga gjuajtjet mbi rrjetë (GJMRRH),
3. Pikët e fituara nga shërbimet (SHRBF),
4. Pikët e humbura nga shërbimet (SHRBH),
5. Pikët e fituara nga bllokuaktiv(BLLOA),
6. Pikët e humbura nga blloku pasiv (BLLOP),
7. Pasimet e gabuara (PASIG),

4.3 TEKNIKA E REALIZIMIT TË NDRYSHOREVE MOTORIKE SITUACIONALE

1. Kërcimi me gjuajtje i ekzekutuar nga lojtaret në fazën e sulmit

Si ndryshore është aplikuar - Gjuajtja mbi rrjetë pikët e fituara(GJMRRF).

Gjuajtja mbi rrjetë eshte nje element teknik që kërkon shume forcë per t'u realizuar.Ajo varet nga kërcimi i lojtares mbi rrjetë. Gjuajtja e drejtë ndahet në katër faza: vrulli, kërcimi,goditja etopit dhe rënia.Gjuajtjet mund të kryhen me rrotullim,merrotullim te krahut dhe kyçit, medredhi apongecje, me hark.

Foto 1. Gjuajtja mbi rrjetë në fazën e sulmit (pikët e fituara)

2. Pikët e humbura nga gjuajtjet mbi rrjetë (GJMRRH),

Pikët e humbura nga gjuajtjet mbi rrjetë nga ana e lojtareve rivale me rastin e vendosjes së bllokut të suksesshëm, apo gjuajtjes së gabuar të lojtares që gjuan mbi rrjetë. (GJMRRH),

Foto 2.Pikët e humbura nga gjuajtjet mbi rrjetë

3. Pikët e fituara nga shërbimet (SHRBF)

Shërbimi është mënyra e dërgimit të topit nga lojtarja në fushën kundërshtare. Nga mënyra e ekzekutimit, ai ndahet në disa mënyra. Por, Shërbimi "tenis", është shërbimi më i përdorur dhe zë rreth 50% të të gjitha mënyrave të shërbimit, dhe një teknikë e suksesshme për të fituar pikë, ose për të penguar organizimin e mire të sulmit te ekipi rival.

Foto 3. Pikët e fituara nga shërbimet

4. Pikët e humbura nga shërbimet (SHRBH)

Shërbimi është menyra e dërgimit të topit nga lojtarja në fushën kundërshtare. Nga mënyra e ekzekutimit, ai ndahet në disa mënyra. Por, Shërbimi "tenis", është shërbimi më i përdorur dhe zë rreth 50% të të gjitha mënyrave të sherbimit, dhe një teknikë e dobët ndikon në humbjen epikës, ose ndikon në organizimin e mirë të sulmit te ekipi rival.

Foto 4. Pikët e humbura nga shërbimet

5. Pikët e fituara nga blloku aktiv (BLLOA),

Lojtaret e qendrës dhe anësoret, bashkëpunojnë për të ndërtuar bllokun. Rolin kryesor e ka lojtari i qendrës. Lojtari ndihmës në bllok, ruan drejtimet e tjera të mundshme të gjuajtjes. Por mund edhe të ndryshohen rolet, lojtaret ndihmëse bëhen kryesore, dhe lojtarjakryesore, bëhet ndihmëse. Pra, në varësi të situatës, ndërtohet edhe blloku, medy apo tri lojtare, me një apo dy duar, me qëllim pengimin e topit të rivalit. Bllokuaktivështë një llojibllokut,në të cilinkrahëtkalojnë mbi rrjetë, dhekur topit të gjuajtur nga kundërshtari, i ndërpritet flurudha, dhe pasi ai godet duart e vënduara në bllok, bie pingul në tokë në fushën e ekipit, i cili ka gjuajtur.

Foto 5. Pikët e fituara nga blloku aktiv

6. Kërcimet në ekzekutimineblloku pasiv dhe pikët

Blloku pasiv është një lloj i bllokut, në të cilin duart janë në pikën e imagjinuar me rrjetën, ose në drejtim me rrjetën shikuar nga lartësia,dhe kur pas topit të gjuajtur nga ana e kundërshtarit, i ndërpritet flurudha në atë mënyrë që ai dëbohet lartë, dhe prapa prej duarve të bllokuesve, dhe bie aty tek lojtarët që gjinden në mbrojtje të fushës dhe e përpunojnë atë.

Foto 6. Kërcimet e ekzekutuara gjatë bllokut pasiv

7. Pasimet e gabuara (PASIG)

Ky element përdoret në situatat e pasimit të topit në rrjet, dhe pranimit të shërbimit (prekja e parë), më së shpeshti në situata të ngritjes (prekja e dytë), dhe në situata të sulmit (kontakt i tretë) pa dhe me kërcim. Ekzistojnë katër variante të ndryshme të këtij elementi të teknikës, të cilat janë:luajtja me top me gishta përpara (përpara trupit),luajtja me top me gishta prapa kokës (pas trupit), luajtja me top me gishta anash, dhe luajtja me top me gishta lart mbi kokë. Si pasime të gabuara janë vlerësuar të gjitha ato pasime, apo ngritje të topit me gishtërinj, të cilat i ka vlerësuar gjyqtari si të gabuara.

Foto 7. Pasimet e gabuara

4.4. METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Në mënyrë qëkërkimi shkencortë jepzgjidhjetë kënaqshme, është e nevojshmeqë të përdorenprocedurat e duhura, të drejta dhe komparative, e qëjanë të natyrës së atij problemi tëdhënë. Duke marrë parasyshtë gjithakëto fakte, për qëllimet ekëtij hulumtimi,janë zgjedhë procedurat,për të cilat konsiderohetsekorrespondojnë menatyrën eproblemeve qëhulumtohen.Kurnuk mund ta përdorimtë ashtuquajturën-statistikën parametrike, (sikur në rastin e hulumtimit tonë) e cila kërkon një shpërndarje (distribucion) normale,dhetë dhëna sasiore (shënime kuantitative), përdoret $\chi 2$-Hi- katror testi, i cili i takontë ashtuquajturës - statistikajoparametrike.

5. INTERPRETIMI I REZULTATEVE DHE DISKUTIMI

5.1. ANALIZA E REZULTATEVE TEKNIKE TE LOJTARET E EKIPIT FITUES KV "SKENDERAJ"

Në tabelat 1-4, janë të paraqitura rezultatet statistikore të pikëve të fituara, gjatë pjesëve të lojës, tevolejbollistet e KV "Skenderaji" pjesmarrëse në finalene Kupës së Kosovës,dhe njëherit fituese e Kupës së Kosovës 2019. Rezultatet statistikore tregojnë, se nga 15 lojtaret e ekipitKV "Skenderaji"8 lojtare janë të përfshira në punim, kurse 7 lojtare, nuk kanë shënuar asnjë pikë, dhe nuk janë të përfshira në përpunimin e rezultateve.

Tabela 1. Elementet e ekzekutuara sipas teknikave në setin e parë KV "Skenderaji"

Teknikat	Shera	Egzona	Zyla	Florentina	Bleona	Elvira	Rukije	Natalie	Gjithsej PF	Gjithsej PH
Gjuajtja F	1	/	/	3	3	3	4	/	14	
Gjuajtja H	1	/	/	1	/	2	1	/		5
Shërbim F	1	2	/	/	/	/	1	/	4	
Shërbim H	/	/	2	/	/	/	/	/		2
Blloku aktiv	/	/	1	/	1	1	1	/	4	
Blloku pasiv	2	/	3	/	2	1	/	/		8
Pasime H	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Gjithsej	/	/	/	/	/	/	/	/	22	15

Tabela 2. Elementet e ekzekutuara sipas teknikave në setin e dytë KV "Skenderaji"

Teknikat	Shera	Egzona	Zyla	Florentina	Bleona	Elvira	Rukije	Natalie	Gjithsej PF	Gjithsej PH
Gjuajtja F	3	/	/	3	2	1	1	/	10	/
Gjuajtja H	3	/	/	/	/	/	5	/	/	8
Sherbim F	/	/	/	/	/	/	2	/	2	/
Sherbim H	1	/	1	1	/	/	2	/	/	5
Blloku aktiv	1	/	/	/	/	1	1	/	3	/
Blloku pasiv	1	/	1	/	1	2		/	/	5
Pasime H	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Gjithsej		/	/	/	/	/	/	/	15	18

Tabela 3. Elementet e ekzekutuara sipas teknikave në setin e tretë KV "Skenderaji"

Teknikat	Shera	Egzona	Zyla	Florentina	Bleona	Elvira	Rukije	Natalie	Gjithsej PF	Gjithsej PH
Gjuajtja F				4	3	3	5		15	
Gjuajtja H				1	1	1	1	1		5
Shërbim F						1			1	
Sherbim H							2			2
Blloku aktiv	1					2			3	
Blloku pasiv	1	1				1	2			5
Pasime H			1							1
Gjithsej									19	13

Tabela 4. Elementet e ekzekutuara sipas teknikave në setin e katërt KV "Skenderaji"

Teknikat	Shera	Egzona	Zyla	Florentina	Bleona	Elvira	Rukije	Natalie	Gjithsej PF	Gjithsej PH
Gjuajtja F	1				4	3	7		15	
Gjuajtja H		1		3	1		2			7
Shërbim F			2						2	
Shërbim H	1	1				1				3
Blloku aktiv	1	1							2	
Blloku pasiv	1		1			2				4
Pasime H										
Gjithsej									19	14

Në setin e parë KV "Skenderaji" rezultati 25:21, ka shënuar 25, pikë prej të cilave, 22 pikë janë fituar nga lojtaret e ekipit–pikët e ekipit fitues, dhe 3 pikë nga gabimet e ekipit rival. Në pjesën e dytë KV "Skenderaji" rezultati 22:25, Kv "Skenderaji" humbë. Ky ekip,ka shënuar 22 pikë, prej të cilave, 15 pikë janë fituar nga lojtaret e ekipit–pikët e ekipit, dhe 7pikë nga gabimet e ekipit rival. Në pjesën e tretë, KV "Skenderaji" rezultati 25:20, ku ekipi fitues ka shënuar 25 pikë, prej të cilave 19 pikë janë fituar nga lojtaret e ekipit,dhe 6 pikë nga gabimet e ekipit rival. Në pjesën e katërt KV "Skenderaji " rezultati 25:23, ku ekipi fitues, ka shënuar 25 pikë, prej të cilave, 19 pikë janë fituar nga lojtaret e ekipit, dhe 6 pikë nga gabimet e ekipit rival.

Shehra Behrami,lojtarja me numër5, nga gjuajtja në setin e parë, ka fituar një pikë, dhenjë pikë e ka humbur. Nga shërbimet ka shënuar një pikë,dhe asnjë shërbim nuk e ka humbur. Nuk ka pasur asnjë bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe ka pasur dy topa të humbur nga blloku pasiv.Nuk ka pasur pasime të humbura. Në setin e dytë ka fituar3 pikë, dhe3 pikë i ka humbur nga gjuajtjet. Nga shërbimet ka fituar një pikë,dhe një shërbim e ka humbur. Nuk ka pasur asnjë bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe asnjë toptë humbur nga blloku pasiv.Nuk ka pasur pasime të humbura. Në setin e tretë, nukka fituarasnjë pikë, dhenuk ka humbur. Nga shërbimet, nuk ka fituar asnjë një pikë,dhe asnjë shërbim nuk e ka humbur. Ka pasur një bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe një top të humbur nga blloku pasiv.Nuk ka pasur pasime të humbura. Në setin e katërt, ka fituarnjë pikë nga gjuajtja mbi rrjetë, dhenuk ka humbur asnjë gjuajtje. Nga shërbimet, nuk ka fituar asnjë pikë,dhe një shërbim e ka humbur. Ka pasur një bllok pozitiv, (pikë të shënuar), dhe një top të humbur nga blloku pasiv.Nuk ka pasur pasime të humbura. Në total,ka fituar5 pikë nga gjuajtja mbi rrjetë, dheka humbur 4 gjuajtje. Nga shërbimet,ka fituar 2 pikë,dhe 2shërbime i ka humbur. Ka pasur 3 blloka pozitiv (pikë të shënuara), dhe 4 topa të humbur nga blloku pasiv.Nuk ka pasur pasime të humbura.

Shehra Behrami	Gjuajtja F	Gjuajtja H	Shërbim F	Shërbim H	Blloku Aktiv	Blloku Pasiv	Pasime H
Seti I	1	1	1			2	
Seti II	3	3	1	1	1		
Seti III					1	1	
Seti IV	1			1	1	1	
Gjithsej	5	4	2	2	3	4	

Egzona Geci,lojtarja me numër8, nga gjuajtja në setin e parë, ka fituar 2 pikë dheasnjë pikë nuk e ka humbur. Nga shërbimet nuk ka shënuar asnjë pikë,dhe asnjë shërbim nuk e ka humbur. Nuk ka pasur asnjë bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe nuk ka pasur asnjë top të humbur nga blloku pasiv.Nuk ka pasur pasime të humbura. Në setin e dytë,nga gjuajtja nuk ka fituar asnjë pikë, dheasnjë pikë nuk e ka humbur.Nga shërbimet,nuk ka shënuar asnjë pikë,dhe asnjë shërbim nuk e ka humbur. Nuk ka pasur asnjë bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe nuk ka pasur asnjë top të humbur nga blloku pasiv.Nuk ka pasur pasime të humbura. Në setin e tretë nga gjuajtja, nuk ka fituar asnjë pikë, dheasnjë pikë nuk e ka humbur. Nga shërbimet nuk ka shënuar asnjë pikë dhe asnjë shërbim nuk e ka humbur. Nuk ka pasur asnjë bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe ka pasur një top të humbur nga blloku pasiv. Në setin e katërt,nuk ka fituarasnjë pikë nga gjuajtja mbi rrjetë, dheka humbur një gjuajtje. Nga shërbimet, nuk ka fituar asnjë

pikë,dhe një shërbim e ka humbur. Ka pasur një bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe asnjë top të humbur nga blloku pasiv.Nuk ka pasur pasime të humbura. Në total,ka fituar2 pikë nga gjuajtja mbi rrjetë, dheka humbur 1 gjuajtje. Nga shërbimet nuk ka fituar asnjë pikë,dhe njëshërbim e ka humbur. Ka pasur një bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe njëtop të humbur nga blloku pasiv.Nuk ka pasur pasime të humbura.

Egzona Geci	Gjuajtja F	Gjuajtja H	Shërbim F	Shërbim H	Blloku Aktiv	Blloku Pasiv	Pasime H
Seti I	2						
Seti II							
Seti III						1	
Seti IV		1		1	1		
Gjithsej	2	1		1	1	1	

Zyla Kadriu, lojtarja me numër një, nga gjuajtja në setin e parë,nukkafituar asnjë pikë, dheasnjë pikë nuk e ka humbur. Nga shërbimet, nuk ka shënuar asnjë pikë,dhe 2shërbime i ka humbur. Kapasur një bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe ka pasur 3 topa të humbur nga blloku pasiv.Nuk ka pasur pasime të humbura. Në setin e dytë, nga gjuajtja nuk ka fituar asnjë pikë, dheasnjë pikë nuk e ka humbur. Nga shërbimet nuk ka shënuar asnjë pikë,dhe një shërbim e ka humbur. Nuk ka pasur asnjë bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe ka pasur një top të humbur nga blloku pasiv.Nuk ka pasur pasime të humbura. Në setin e tretë nga gjuajtja, nuk ka fituar asnjë pikë, dheasnjë pikë nuk e ka humbur. Nga shërbimet nuk ka shënuar asnjë pikë,dhe asnjë shërbim nuk e ka humbur. Nuk ka pasur asnjë bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe nuk ka pasur asnjë top të humbur nga blloku pasiv. Ka pasur një pikë të humbur nga pasimi jo i drejtë. Në setin e katërt,nuk ka fituarasnjë pikë nga gjuajtja mbi rrjetë, dhenuk ka humbur asnjë gjuajtje. Nga shërbimet ka fituar 2 pikë,dhe asnjë shërbim nuk e ka humbur. Nuk ka pasur asnjë bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe një top të humbur nga blloku pasiv. Nuk ka pasur pasime të humbura. Në total nuk ka fituarasnjë pikë nga gjuajtja mbi rrjetë, dheas nuk ka humbur asnjë gjuajtje. Nga shërbimet,ka fituar 2 pikë,dhe 3shërbime i ka humbur. Ka pasur një bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe 5 topa të humbur nga blloku pasiv. Ka pasur një pikë të humbur nga pasimi jo i drejtë.

Zyla Kadriu	Gjuajtja F	Gjuajtja H	Shërbim F	Shërbim H	Blloku Aktiv	Blloku Pasiv	Pasime H
Seti I				2	1	3	
Seti II				1		1	
Seti III							1
Seti IV			2			1	
Gjithsej			2	3	1	5	1

Florentina Deliu,lojtarja me numër 15, nga gjuajtja në setin e parë, ka fituar 3 pikë, dhenjë pikë e ka humbur. Nga shërbimet, nuk ka shënuar asnjë pikë,dhe asnjëshërbim nuk e ka humbur. Nuk ka pasur asnjë bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe nuk ka pasur asnjë top të humbur nga blloku pasiv.Nuk ka pasur pasime të humbura. Në setin e dytë nga gjuajtja,ka fituar 3 pikë, dheasnjë pikë nuk e ka humbur. Nga shërbimet, nuk ka shënuar asnjë pikë,dhe një shërbim e ka humbur. Nuk ka pasur asnjë bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe nuk ka pasur asnjë top të humbur nga blloku pasiv. Nuk ka pasur pasime të humbura. Në setin e tretë,nga gjuajtja ka fituar 4 pikë, dhenjë pikë e ka humbur. Nga shërbimet, nuk ka shënuar asnjë pikë,dhe asnjë shërbim nuk e ka humbur. Nuk ka pasur asnjë bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe nuk ka pasur asnjë top të humbur nga blloku pasiv.Nuk ka pasur pasime të humbura. Në setin e katërt,nuk ka fituarasnjë pikë nga gjuajtja mbi rrjetë, dheka humbur 3gjuajtje. Nga shërbimet,nuk ka fituar asnjë pikë,dhe asnjë shërbim nuk e ka humburr. Nuk ka pasur asnjë bllok pozitiv (pikë të shënuar) dhe asnjë top të humbur nga blloku pasiv.Nuk ka pasur pasime të humbura. Në total ka fituar10 pikë nga gjuajtja mbi rrjetë, dheka humbur 5 gjuajtje.Nga shërbimet nuk ka fituar asnjë pikë,dhe asnjëshërbimnuk e ka humbur. Nuk ka pasur asnjë bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe asnjë top nuk e ka humbur nga blloku pasiv. Nuk ka pasur asnjë pikë të humbur nga pasimi jo i drejt.

Florentina Deliu	Gjuajtja F	Gjuajtja H	Shërbim F	Shërbim H	Blloku Aktiv	Blloku Pasiv	Pasime H
Seti I	3	1					
Seti II	3			1			
Seti III	4	1					
Seti IV		3					
Gjithsej	10	5		1			

Bleona Kadriu, lojtarja me numër 2, nga gjuajtja në setin e parë, ka fituar 3 pikë, dheasnjë pikë nuk e ka humbur. Nga shërbimet, nuk ka shënuar asnjë pikë,dhe asnjëshërbim nuk e ka humbur. Kapasur një bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe ka pasur 2 topa të humbur nga

blloku pasiv.Nuk ka pasur pasime të humbura. Në setin e dytë nga gjuajtja,ka fituar 2 pikë, dheasnjë pikë nuk e ka humbur. Nga shërbimet, nuk ka shënuar asnjë pikë,dhe një shërbim e ka humbur. Ka pasur një bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe ka pasur 2 topa të humbur nga blloku pasiv. Nuk ka pasur pasime të humbura. Në setin e tretë,nga gjuajtja ka fituar 3 pikë, dhenjë pikë e ka humbur. Nga shërbimet, nuk ka shënuar asnjë pikë,dhe asnjë shërbim nuk e ka humbur. Nuk ka pasur asnjë bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe nuk ka pasur asnjë top të humbur nga blloku pasiv.Nuk ka pasur pasime të humbura. Në setin e katërt, ka fituar4 pikë nga gjuajtja mbi rrjetë, dheka humbur një gjuajtje. Nga shërbimet nuk ka fituar asnjë pikë,dhe asnjë shërbim nuk e ka humbur. Nuk ka pasur asnjë bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe asnjë top të humbur nga blloku pasiv.Nuk ka pasur pasime të humbura. Në total ka fituar12 pikë nga gjuajtja mbi rrjetë, dheka humbur 2 gjuajtje. Nga shërbimet nuk ka fituar asnjë pikë, dhe asnjëshërbim nuk e ka humbur. Kapasur një bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe 3topai ka humbur nga blloku pasiv. Nuk ka pasur asnjë pikë të humbur nga pasimi jo i drejt.

Bleona Kadriu	Gjuajtja F	Gjuajtja H	Shërbim F	Shërbim H	Blloku Aktiv	Blloku pasiv	Pasime H
Seti I	3				1	2	
Seti II	2					1	
Seti III	3	1					
Seti IV	4	1					
Gjithsej	12	2			1	3	

Elvira Bjraktari,lojtarja me numër 4, nga gjuajtja në setin e parë, ka fituar 3 pikë dhe2 pikë i ka humbur. Nga shërbimet, nuk ka shënuar asnjë pikë,dhe asnjëshërbim nuk e ka humbur. Ka pasur një bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe ka pasur një top të humbur nga blloku pasiv.Nuk ka pasur pasime të humbura. Në setin e dytë, nga gjuajtja,ka fituar një pikë dheasnjë pikë nuk e ka humbur. Nga shërbimet, nuk ka shënuar asnjë pikë,dhe asnjë shërbim nuk e ka humbur. Ka pasur një bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe ka pasur 2 topa të humbur nga blloku pasiv. Nuk ka pasur pasime të humbura. Në setin e tretë,nga gjuajtja,ka fituar 3 pikë, dhenjë pikë e ka humbur. Nga shërbimet,ka shënuar një pikë,dhe asnjë shërbim nuk e ka humbur. Kapasur 2 blloka pozitiv (pikë të shënuara), dhe ka pasur një top të humbur nga blloku pasiv.Nuk ka pasur pasime të humbura. Në setin e katërt, ka fituar3 pikë nga gjuajtja mbi rrjetë, dhe nukka humbur asnjë gjuajtje. Nga shërbimet nuk ka fituar asnjë pikë,dhe një shërbim nuk e ka humbur. Nuk ka pasur asnjë bllok pozitiv (pikë të shënuar), dhe një top të humbur nga blloku pasiv.Nuk ka pasur

pasime të humbura. Në total ka fituar10 pikë nga gjuajtja mbi rrjetë, dheka humbur 3 gjuajtje. Nga shërbimet ka fituar një pikë,dhe njëshërbim e ka humbur. Ka pasur 4 blloka pozitiv (pikë të shënuara), dhe 6topa i ka humbur nga blloku pasiv. Nuk ka pasur asnjë pikë të humbur nga pasimi jo i drejt.

Elvira Bajraktari	Gjuajtja F	Gjuajtja H	Shërbim F	Shërbim H	Blloku Aktiv	Blloku pasiv	Pasime H
Seti I	3	2			1	1	
Seti II	1				1	2	
Seti III	3	1	1		2	1	
Seti IV	3			1		2	
Gjithsej	10	3	1	1	4	6	

